

eppc kërkon *Menaxher të Zhvillimit të Biznesit* për klientin e saj, i cili është një ndër kompanitë më të mëdha në vend në fushën e Menaxhimit.

NJË VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM:

Menaxheri i Zhvillimit të Biznesit ka për qëllim të përmirësojë pozicionin në treg dhe zhvillimin financiar të një kompanie. Ky person përcakton qëllimet strategjike afatgjata, ndërton marrëdhëniet me klientët, identifikon mundësitë e biznesit, negocion, realizon marrëveshje biznesi dhe njuh mirë kushtet aktuale të tregut.

Përgjegjësitë Kryesore:

1. Ngre dhe zhvillon konceptin e “property management” të kompanisë me qëllim identifikimin dhe zhvillimin e reputacionit në treg;
2. Identifikon dhe zhvillon marrëdhëniet me klientë të rinj potencial, vendos target, ofron suport e mbështetje me qëllim ruajtjen e marrëdhënieve me ta;
3. Zhvillon dhe mban marrëdhëniet me klientët ekzistues, duke prezantuar zgjidhje apo shërbime të reja për ta;
4. Bashkëpunon me menaxherët, stafin e marketingut dhe atë teknik për përcaktimin e mënyrave të reja të shitjeve;
5. Menaxhon dhe përcakton linjat kryesore të dep të tjera në lidhje me zhvillimin e biznesit të kompanisë;
6. Harton planin e përgjithshëm strategjik duke zhvilluar dhe planifikuar kanalet dhe rrugët kryesore të rritjes së të ardhurave të kompanisë.

Kërkesat për këtë pozicion janë:

- Diplomë Universitare në Administrim Biznes, Marketing;
- Përvojë mbi 5 vjet në fushën e Marketingut dhe Shitjeve;
- Njohje të shkëlqyer të gjuhës Angleze, njohja e Italishtes përbën avantazh;
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi, organizimi dhe negocimi.

Të dhënat:

Pozicioni:	Menaxher i Zhvillimit të Biznesit;
Vendndodhja:	Tiranë;
Orari:	Nga e Hëna në të Shtunë;
Pagesa:	Në nivel drejtuesi;
Kontrata:	Sipas Kodit të Punës;
Aplikimet mbyllen:	10.04.2016.

Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj dhe dokumentet e tjera shoqëruese duke **përmendur pozicionin për të cilin aplikoni** në adresën e e-mailit:

recruitments@eppc.al

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj dhe dokumentet shoqëruese do të kualifikohen.